FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 106

Tiranë – E premte, 5 qershor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 72/2020 datë 4.6.2020	Për emetimin e instrumentit "Eurobond" nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe heqjen dorë nga imuniteti.....	6081
Dekret i Presidentit nr. 11503, datë 5.6.2020	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit....	6081

LIGJ
Nr. 72 /2020

PËR EMETIMIN E INSTRUMENTIT "EUROBOND" NGA MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË, MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA TATIMET E TAKSAT DHE HEQJEN DORË NGA IMUNITETI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë, lidh marrëveshje për emetimin e instrumentit "Eurobond", thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre që i bashkëlidhet këtij ligji.
2. Emetuesi, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar nga ndonjë mosmarrëveshje, heq dorë nga imuniteti, sipas përcaktimeve në aktet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 2

Mbajtësit e titujve të eurobondit dhe menaxherët bashkëdrejtues, sipas marrëveshjeve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 1 të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe nga çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë, për të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen dhe tregtimin e eurobondeve.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

Miratuar në datën 4.6.2020

Shpallur me dekretin nr. 11503, datë 5.6.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11503, datë 5.6.2020

PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 72/2020 "Për emetimin e instrumentit "Eurobond" nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe heqjen dorë nga imuniteti".

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 72/2020 "Për emetimin e instrumentit "Eurobond" nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe heqjen dorë nga imuniteti".

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 28 lekë